



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 438/4 Prot

Tiranë, më 13.07.2021

V E N D I M

Nr.99, datë 13.07.2021

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga njësia përgjegjëse gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit të publikuar me shpalljen #3548, për plotësimin e pozicionit “Drejtor i Drejtorisë së Organeve Certifikues dhe Inspektues”, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me respektimin dhe zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit të publikuar me shpalljen #3548, për plotësimin e pozicionit “Drejtor i Drejtorisë së Organeve Certifikues dhe Inspektues”, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit,

VËREJ SE:

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar me nr. 438 prot., datë 30.03.2021, nëpunësi *****, ka ngritur pretendimin se gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit për plotësimin e pozicionit “Drejtor i Drejtorisë së Organeve Certifikues dhe Inspektues”, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, të publikuara në shpalljen me kod #3548, njësia përgjegjëse

ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Për verifikimin e këtyre pretendimeve, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil administroi dhe shqyrtoi materialin shkresor që shoqëronte kërkesën e nëpunësit, si dhe dokumentacionin e marrë prej Departamentit të Administratës Publike, që materializon këtë procedurë administrative.

Shkaku i mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi, lidhet me pretendimin e ankuesit se kriteret e përcaktuara nga DAP, lidhur me kërkesat e posaçme që duhet të plotësojnë nëpunësit civil pretendentë për pozicionin e sipër përmendur, janë diskriminuese dhe bien në kundërshtim ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; procedurat e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, Rregulloren Europiane 765/2008, duke cenuar rëndë parimet e administrimit të shërbimit civil, i cili udhëhiqet nga ligji dhe bazohet në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, si dhe garanton qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë në detyrë të nëpunësit civil.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së sqarimeve të dhëna si dhe dokumentacionit të mbledhur gjatë hetimit administrativ, rezulton se, në zbatim të planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2021, njësia përgjegjëse DAP, ka publikuar në portalin e tij shpalljen për procedurën e konkurrimit si më poshtë:

Shpallja me kod #3548, për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë për pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Organeve Certifikues dhe Inspektues”, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit ;

Nevoja e plotësimit të këtij pozicioni, ka lindur pas implementimit të Urdhrit nr. 2, datë 12.01.2021, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit”, proces i cili ka diktuar ristrukturimin e institucionit.

Si rrjedhojë e procesit të mësipërm, struktura e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, ka pësuar ndryshime. Konkretisht, konstatohet se, në strukturën e mëparshme ka pasur vetëm dy njësi organizative në nivel drejtorie, “Drejtoria e Akreditimit” dhe “Drejtoria e Zhvillimit”, si dhe një njësi organizative në nivel sektori me emërtesën “Sektori i Financës dhe Shërbimeve”, ndërsa struktura aktuale është e organizuar si më poshtë :

1. Drejtoria e Organeve Certifikues dhe Inspektues;
2. Drejtoria e Laboratorëve Testues, Kalibrues dhe Mjekësore;

3. Drejtoria e Zhvillimit;
4. Menaxher Cilësie;
5. Sektori i Financës dhe Shërbimeve

Pra, “Drejtoria e Akreditimit” e strukturës së mëparshme, është suprimuar dhe janë krijuar dy drejtori të tjera: “Drejtoria e Organeve Certifikues dhe Inspektues” dhe “Drejtoria e Laboratorëve Testues, Kalibrues dhe Mjekësore” e në të njëjtën kohë është krijuar pozicioni i ri “Menaxher cilësie”.

Ky ndryshim organizativ, në zbatim të pikës 14, të vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, është shoqëruar edhe me hartimin përshkrimeve të reja të punës, apo plotësimin e përshkrimeve të mëparshme.

Në analizë të gjithë sa u parashtrua më sipër, ku përfshihen pretendimet e ankuesit, dokumentacioni i dërguar nga Departamenti i Administratës Publike, si dhe aktet e publikuara në portal, të cilat materializojnë procedurën e konkurrimit, arrihet në përfundimin se, njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, ka vepruar në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit nëpërmjet lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë për shpalljen me kod #3548, për arsyet që do të evidentohen në vijim.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit ***** se, njësia përgjegjëse (DAP), ka pranuar përshkrimet e reja të punës, me kërkesa të posaçme diskriminuese, për pozicionin e punës “Drejtor i Drejtorisë së Organeve Certifikues dhe Inspektues” pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, publikuar me numër shpallje #3548, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Rregulloren Europiane 765/2008 dhe procedurat e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, sqaroj si më poshtë:

Vendimi nr. 142, datë 12.03.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, përcakton procedurën që duhet të ndiqet në lidhje me miratimin e përshkrimeve të punës. Konkretisht për institucionet e administratës shtetërore, ky proces kërkon bashkërendimin e punëve midis analistit, eprorëve direkt të pozicionit respektiv të punës dhe Sekretarit të Përgjithshëm të ministrisë, i cili miraton këto akte. Më tej, është njësia përgjegjëse (DAP) e cila finalizon këtë procedurë nëpërmjet miratimit të

përshkrimeve ose kthimit për rishikim të tyre, në rast se vëren se këto akte nuk janë hartuar në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë këtij hetimi, konstatoj se, përshkrimi i punës në rastin e pozicionit *“Drejtor i Drejtorisë së Organeve Certifikues dhe Inspektues”*, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, është i hartuar nga eprori dhe nënshkruar rregullisht nga Sekretari i Përgjithshëm i ministrisë së linjës. Në të njëjtën kohë nuk rezultojnë ndonjë rezervë, vërejtje apo kthim i materialit, nga ana e njësisë përgjegjëse, fakt që përcakton se gjithçka është kryer duke u respektuar procedura e mësipërme.

Vetëm pas kësaj, Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimit ka përcjellë kërkesën për plotësimin e vendeve vakante nëpërmjet shpalljes së tyre në faqen zyrtare të DAP, shoqëruar me përshkrimin e punës për pozicionin e sipërpërmendur, ku janë të mirëpërcaktuara kriteret e posaçme, ku përfshihen niveli dhe lloji i arsimit, përvoja e punës, trajnime/certifikime etj., në të cilat nuk vërehen kërkesa të shtuara apo me karakter diskriminues, por janë kërkesa që lidhen me nivelin e kërkuar të formimit, që duhet të zotërojë nëpunësi që do të kandidonte për të marrë pjesë në këtë konkurrim.

Në vijim, Departamenti i Administratës Publike, në zbatim të nenit 26, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të vendimit nr.242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave *“Për plotësimin e vendeve vakante të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”* i ndryshuar, ka kryer publikimin këtij pozicioni të lirë, në faqen e vet zyrtare.

Në këto kushte, arrihet në përfundimin se kriteret e posaçme të përcaktuara në shpalljen me kod **#3548**, për pozicionin e punës *“Drejtor i Drejtorisë së Organeve Certifikues dhe Inspektues”*, në Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit, janë në përputhje me përshkrimin e punës të miratuar dhe me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, prandaj hetimi administrativ duhet të përmbillet dhe çështja të arkivohet.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe në nenin 34, pika 1, të Rregullores, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të njësisë përgjegjëse në zhvillimin e procedurës së konkurrimit të publikuar me shpalljen #3548, për plotësimin e pozicionit “*Drejtor i Drejtorisë së Organeve Certifikues dhe Inspektues*”, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, dhe meqë nuk u konstatuan shkelje të dispozitave të legjislacionit të shërbimit civil, arkivimin e çështjes.
2. Të njoftohet për këtë vendim Departamenti i Administratës Publike, Ministria e Financave dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha